

VENDIM
Nr. 561, datë 29.7.2016

**PËR STANDARDIZIMIN DHE DISIPLINIMIN E SHPENZIMEVE TË
KARBURANTIT NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME¹**

(Ndryshuar me VKM nr.344, datë 12.6.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

1 / 1 Bëjnë përjashtim nga pika 1, e këtij vendimi, strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit, të cilat, për shkak të natyrës së punës, mund të përdorin kartë elektronike që nuk mundëson identifikimin e mjetit të transportit dhe të përdoruesit të saj, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzime të ministrit të Brendshëm.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ VKM nr.561, datë 29.7.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.151, datë 11 gusht 2016.
VKM nr.344, datë 12.6.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.89, datë 19 qershor 2018.